




ATDHEU, VENDI MË I BUKUR



NEWBORN

QEVERISJA E KOSOVËS ËSHTË NË DORËN TËNDE

FITIM (13), DIOLA (13), ARTOL (13), ERRIS (13), ADEA (14), ELMA (14), LISI (13)



Mirë se erdhët në artikullin tonë. Në këtë artikull do shqyrtohet tema kryesore që është demokracia dhe vlera e saj

Demokracia është udhëheqje e përbashkët. Kjo nënkupton se nuk udhëheq vetëm një person, por udhëheqin të gjithë. Pa marrë parasysh gjininë, racën, moshën dhe fenë e personave të gjithë i kanë të drejtat e barabarta. Demokracia brenda vetes përfshin këto elemente: lirinë e shprehjes, lirinë e lëvizjes, lirinë e zgjedhjes, tolerancën, respektin, solidaritetin, etj. De-

shumicë. Kjo gjë tek vendi ynë nuk qëndron kështu. Ne mendojmë se në Kosovë të gjithë trajtohen të barabartë, pavarësisht dallimeve personale që mund t'i kenë. Kjo i jep vlerë edhe më shumë shtetit tonë, i cili e pranon dhe e respekton diversitetin. Ndër të tjerash, Kosova ka demokraci përfaqësuese me sistem parlamentar. Kjo nënkupton se një qytetar ka të drejtë të votoj personin që mendon që është i denjë për ta përfaqësuar vendin tonë ashtu siç duhet. Kuvendi përbëhet nga 120 deputetë të cilët votojnë Presidentin, Kryetarin e Kuvendit dhe Qeverinë. Këtë fuqi për të zgjedhur këta persona kaq të rëndësishëm për shtetin ua kemi dhënë ne qytetarët, me votën tonë. Mos harroni, demokracia nuk tenton që të gjithve të na bëjë mendimet e njëjta, por ajo e vlerëson bashkimin e mendimeve të ndryshme dhe respektimin e tyre. Andaj, fillo ndryshimin duke vepruar në mënyrë demokratike, për një të ardhme më të mirë.




Nëse ka tolerancë ka edhe demokraci

demokracia për herë të parë është shfaqur në Greqi në vitin 507 të shekullit të VI-të. Në atë kohë, niveli i demokracisë nuk ishte shumë i zhvilluar. Me kalimin e viteve filloj të avancohej. Demokracia është e rëndësishme për të gjithë ne si qytetarë. Për shembull, në disa vende të ndryshme të botës, komunitetet e tjera jo shumicë, nuk janë të barabarta me komunitetin



Jemi të drejtë dhe shumë të përgjegjshëm



Të drejtat tona janë të garantuara me ligj. Ne si fëmijë e kemi të drejtën e shkollimit, të drejtën e strehimit, të drejtën e familjes, të drejtën e lojës, të drejtën për të shprehur mendimet tona, etj. Pra, në demokraci zëri ynë dëgjohe




Për të jetuar në një vend paqësor, secili nga ne duhet të jetë i përgjegjshëm për veprimet që i bën. Lirinë që e kemi duhet ta gëzojmë duke u angazhuar në të mirë të vendit tonë



Qytetarët aktiv luajnë rol kyç në zhvillimin e demokracisë. Të gjithë ata qytetarë të cilët kontribuojnë në vendin e tyre, qoftë duke pastruar ambientin, duke u kujdesur për shoqërinë, duke votuar në procesin zgjedhor, janë qytetarë aktiv

LIRIA PËR TË ZGJEDHUR

JETMIR (14), BESMIR (14), LISI (13), ARDI (13), YLLKA (13), RRONA (13), FIONA (13)



Në demokraci vendimmarrja i takon popullit. Kështu pra, të gjithë qytetarët të cilët janë mbi moshën 18 vjeçare e kanë të drejtën e votës në procesin zgjedhor

Të gjithëve na ka ndodhur të zgjedhim diçka. Për shembull, na ka ndodhur të zgjedhim mes dy fustaneve, dy palë këpucëve ose mes dy brendeve të ndryshme. Ndonjëherë kemi pasur mëdyshje për ato zgjedhje. Por, zakonisht në fund zgjedhim atë që ne e pëlqejmë. Këto janë vetëm disa shembuj nga jeta jonë e përditshme.

Kurse, kur bëhet fjalë për procesin zgjedhor në demokraci, këtu zgjedhja ndikon në jetën e secilit prej neve. Duke votuar në mënyrë të fshehtë qytetarët zgjedhin përfaqësuesit e vendit të cilët pastaj marrin vendime shumë të rëndësishme.

Qytetarët i zgjedhin ata që mendojnë se janë të denjë për atë pozitë. Pra, ata të cilët i përfaqësojnë interesat e popullit. Përfaqësuesit duhet të jenë të përgjegjshëm dhe të mundohen të japin më të mirën e mundshme për popullin gjatë mandatit të tyre 4 vjeçar. Kandidatët për përfaqësues të popullit, japin premtime dhe tregojnë se çfarë do të bëjnë gjatë mandatit të tyre. Në këtë mënyrë, qytetarët e kanë më të lehtë të zgjedhin për më të mirin/en që ata e mendojnë.

Në shtetin tonë Kosovën, ndodhin dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet qendrore dhe zgjedhjet komunale. Në zgjedhjet qendrore qytetarët i votojnë kandidatët për deputetë. Kurse, në zgjedhjet komunale qytetarët i votojnë kandidatët për kryetar të komunës dhe asamblistë.

Rëndësia e votës është shumë e madhe, sepse një votë sjell ndryshimin. E drejta e votës që secili qytetar e gëzon, duhet të shfrytëzohet. Duke qenë kështu të përgjegjshëm si qytetarë. Prandaj, mesazhi ynë është: „Votoni, sepse kështu sjellim ndryshimin!“.



Ne jemi autorët e këtij artikulli. Gjatë diskutimit kuptuam shumë gjëra të mira, të cilat na i sjell demokracia. Liria jonë për të zgjedhur është pikërisht një ndër elementet kryesore të demokracisë


NE JEMI AKTIV

ELION (13), ARTI (14), OLTİ (13), YLBINA (13), TRINGA (13), ELDA (13), VERONA (13)



Sa mirë është të aktivizohesh për vendin tënd dhe të ndikosh që vendi yt të ketë progres. Këtë mund ta bëjmë të gjithë. Për më shumë Informata, vazhdoni të lexoni më poshtë

Kohët e fundit të gjithë jemi dëshmitarë, ose të paktën kemi dëgjuar në lajme, se në Prishtinë, ajri është i



ndotur. Kjo është shqetësuese për të gjithë qytetarët. Për këtë arsye, një numër i madh i tyre janë mbledhur me datë 31 janar para Teatrit Kombëtar në kryeqytet. Qytetarët e Kosovës, kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre të protestimit në lidhje me një çështje shqetësuese për ta, siç është ndotja e ajrit. Kjo është demokracia. Të gjithë ne qytetarët kemi të drejtë të shprehemi lirshëm dhe të tregojmë pakënaqësitë tona edhe përmes protestës. Për më tepër, marrja pjesë në protesta (gjithmonë paqësore) na bën neve qytetarë aktiv. Kjo tregon

se ne jemi të brengosur se çfarë po ndodh në vendin tonë. Andaj, gjithçka që ne bëjmë për të përmirësuar vendin tonë është qytetari aktive. Përpos protestës, aktiv mund të jemi edhe duke marrë pjesë në procesin zgjedhor, duke nënshkruar peticione, duke bërë punë vullnetare, etj. Të mos harrojmë se demokracia na ofron edhe shumë të drejta. E drejta e shkollimit, e votës, e shprehjes së lirë, janë vetëm disa nga të drejtat që të gjithë ne i gëzojmë, pa dallime.

Megjithatë, ne kemi përgjegjësi ndaj vendit tonë. Për shembull, kemi përgjegjësi respektimin e ligjit, pagesën e taksave, ruajtjen e ambientit, ruajtjen e pronave publike, etj.

Ne shpresojmë që sado pak ju kemi bërë të kuptoni se sa të rëndësishëm jemi ne qytetarët në demokraci. Prandaj, të punojmë sa më shumë për vendin tonë. Vendi ynë ka nevojë për aktivizimin tonë.



Gjatë shkruarjes së artikullit dhe bashkëpunimit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Fehmi Agani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjakovë